

# RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019 DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

## KOMUNA RAHOVEC

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI / KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKË OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No <u>02</u> (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No <u>233</u> Nr. ifaq/Br.str./No.pg <u>24</u>	
Data/Datum/Date <u>21 / 01 / 2020</u>	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

## RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019

### DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin kalendarik 2019, sipas dinamikës së punëve DPI ka zbatuar të gjitha ligjet përkatëse, sipas specifikave të lëmive të inspektorëve: tregtisë, sanitarisë, veterinarisë, ndërtimtarisë, pronësisë, komunikacionit dhe të mjedisit. Mbikëqyrja efektive e zbatimit të ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve komunale dhe dispozitave të tjera relevante sipas fushëveprimit të drejtorisë ishin synimi ynë kryesor gjatë vitit 2019.

Drejtoria për Punë Inspektuese, përkundër pengesave dhe vështirësive të natyrave të ndryshme, me sukses ka arritur të përmbrushë objektivat e punës për vitin 2019. Plani i përgjithshëm njëvjeçar, edhe pse ka qenë i detajuar sipas specifikave të sektorëve, ne jemi përshtatur me veprime sipas kohës dhe karakteristikave që janë kërkuar. Në vazhdim ju paraqesim raportin vjetor të punës për vitin 2019 të kategorizuar në periudha tremujore.

#### Tremujori i parë : janar, shkurt, mars

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, kemi bërë kompletimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak, duke respektuar afatet procedurale e ligjore. Me qëllim të rritjes së disciplinës dhe ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve në autoritetin e Inspektorit, është marrë vendim nga ana e Kryetarit të Komunës që të gjithë Inspektorët e Drejtorisë për Punë Inspektuese të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës dhe gjatë vikendeve për nëntë muaj nga data 4.03.2019 deri më 4.12.2019, në mënyrë që të shtohet intesiteti i punës së inspektorëve.

Në kuadër të Sektorit të Tregut, janë inspektuar të gjithë prodhuesit e bukës rreth kushteve dhe standardeve të kërkuaara për punë, pas urdhëresës së MTI-së kemi urdhëruar dyqanet ushqimore që të largojnë nga tregu produktet me origjinë nga shteti i Serbisë me mbishkrimet; "Kosovo Metohija dhe Kosovo Unmik". Në koordinim dhe bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacionin Policor Rahovec janë zhvilluar aksione për mbylljen e lokaleve të lojërave të fatit.

#### Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Në tremujorin e dytë të vitit 2019 kemi shpeshtuar inspektimet për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së përgjithshme për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit dhe ndëshkimin e të gjithë atyre që qëllimshëm e dëmtojnë mjedisin dhe hapësirat publike, duke shqiptuar kështu 15 dënimë mandatore. Poashtu, kemi kryer inspektimet e nevojshme në subjektet afariste ku të gjitha këto subjekte janë obliguar në lidhjen e kontratave për grumbullimin e mbeturinave me kompanitë: " EKO-REGJIONI" & "EKO DRINIA".

Në këtë fazë kryesisht ku fillojnë ndërtimet pranverore ne kemi qenë vazhdimisht në vëzhgim të terrenit, gjatë kontrollimeve kemi verifikuar objektet të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi dhe janë marrur masat paraprake të parapara me ligjet e ndërtimit dhe rregulloret në fuqi, janë shqiptuar gjithsej 17 dënimë mandatore, si dhe kemi bërë rrënimin e objekteve pa leje dhe objekteve të vjetra në Komunën e Rahovecit.

## RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019

Angazhimi maksimal nuk ka munguar edhe në kontrollin e shfrytëzimit të të gjitha sipërfaqeve publike në territorin e Komunës së Rahovecit, ku nga ana e inspektorit të çështjeve komunale është bërë mbikëqyrja e kyçjeve në sistemin e rrjetit të ujësjellësit publik nga personat fizikë dhe juridik, mënyra e shfrytëzimit dhe keqpërdorimet eventuale të ujit të pijshëm (larja e rrugëve, sipërfaqeve të hapura publike, autolarjet, ujitja e kopshteve etj), mbikëqyrja e ndërhyrjeve eventuale mbi infrastrukturën rrugore (ekzekutimi i punëve publike apo private), mbikëqyrja e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara.

*Të arriturat gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019: Krahas prioriteteve siç janë: Eliminimi i konkurrencës së padrejtë tregtare, mbrojtja e hapësirave publike, krijimi i një mjedisi të pastër, parandalimi i ndërtimeve ilegale, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, e prioriteti dhe fokusi ynë kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve, për ç'arsye janë zhvilluar aksione të vazhdueshme në terren për largim të mallrave ushqimore të cilësuara si të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve.*

### Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Këtë periudhë tremujore e karakterizon fluks më i shtuar i numrit të automjeteve nga mërgimtarët tanë, si dhe sezona e pushimeve verore, andaj, inspektori i komunikacionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacionin Policor në Rahovec dhe Njësinë e Trafikut, janë kujdesur për krijimin e sigurisë më të madhe dhe qarkullimin e lirë në komunikacion.

Në fushën e transportit publik, në vazhdimësi kemi përcjellë nga afér punën e kompanive të licencuara të autobusëve, të cilat janë duke i mbuluar mjaftueshëm dhe sigurt linjat e transportit të udhëtarëve, në kuadër të përgjegjësive tona për sinjalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve në vazhdimësi jemi munduar që mjaftueshëm të mbulojmë të gjitha rrugët në qytet dhe shumicën e rrugëve nëpër fshatra me sinjalizimin e nevojshëm. Gjatë tërë vitit nëpërmjet të kontraktuarit kemi ndërryrë për rregullimin e vendkalimeve për këmbësorë në gjithë qytetin.

### Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Gjatë kësaj periudhe raportuese për vitin 2019, kemi bërë kontrollimin e mishtoreve dhe thertoreve, ku gjatë kësaj periudhe njëvjeçare të inspektimeve të rregullta janë konfiskuar dhe asgjësuar 73.70 kg produkte ushqimore me prejardhje shtazore, prodhuesit e mishit i kemi urdhëruar që të pajisin të gjithë punëtorët me libreza sanitare.

Në fushën e gastronomisë bazuar në raportet nga terreni, gjendja e përgjithshme higjieno- sanitare e restauranteve, gjelltoreve, fast- foodeve të ndryshëm në komunën e Rahovecit është në nivelin mesatar, me IKSHPK-në kemi pasur bashkëpunim të vazhdueshëm në lëminë e sanitarisë. Gjatë tërë vitit 2019 ka vazhduar inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet joligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinare dhe bujqësore. Sigurisht, se prioriteti kryesor dhe fokus i fundit të vitit 2019 ka qenë realizimi i buxhetit, rritja e presionit në mënyrë të vazhdueshme në gjykata me qëllim shqyrtimin e

## RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019

lëndëve të dërguara nga inspektorati, pranim-shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve.

*Të arriturat gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019: Kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që hapësirat publike të jenë sa më lehtësish të qasshme për qytetarët, për këtë arsy e në mënyrë permanente e në koordinim dhe bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacionin Policor Rahovec kemi inspektuar për largimin e shitësve ambulant nga rruga, trotuari dhe hapësirat gjelbëruese, poashtu, kemi bërë informimin e qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga Komuna etj.*

**Në vijim të bashkangjitur gjeni tabelarin e punës së inspektorëve për periudhën reportuese janar-dhjetor 2019:**

**TABELARI I PUNËS PËR INSPEKTOR (janar- dhjetor 2019)**

Inspektori	Inspektime të planifikuara	Procesverbale të realizuara	Aktvendime	Fletëparaqitje	Dënine mandatore	Njoftime Kërkesa Raporte	Fletëparaqitje të ekzekutuarë nr & shuma	Ftesa, Kërkesa Konkluza
Nezir Thaqi	328	260	15	5	0	26	0	0
Hasan Eminazeri	Ndërtim: 304	Ndërtim: 402	59	27	17	18	Vlera: 17	
Fehmi Shehu	406	509	0	0	0	65	238€	0
Mehdi Shehu	465	485	59	0	0	4	0	P.tan.47
Milazim Elshani	275	273	4	2	0	Kërkesa: 12	1	0
Masar Vuçitërrna	360	337	25	0	0	Aksione: 6	1,900.00€	0
Metush Isma	336	Ambientit: 307 Pylltarisë: 344	37	20	15	50	220€	0
Valon Hoti	360	377	10	0	0	3	0	0
		Proces. Pune: 43	Akt.pune: 43					
Shaqir Berisha	310	364	22	0	0	0	0	0
Sherafedin Shehu	290	289	15	0	0	0	0	Ftesa: 2
Sabahajdin Qeska	438	596	129	37	0	9	51 lëndë të ek. Vlera: 3,600€	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>4178</b>	<b>4909</b>	<b>434</b>	<b>81</b>	<b>32</b>	<b>193</b>	<b>28,658.00€</b>	<b>19</b>

**Drejtori i Drejtorisë për Punë Inspektuese**

